



2-180/8157
30 09 2022

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/180/25
Datë: 27.09.2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12,2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr: 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 27 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr: 03/L-048, GZRK numër 2008/27) dhe nenit 22 paragrafi 22,1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më datë 27.09.2022 nxjerrë:

V E N D I M

Për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake të vitit 2022

I. Me këtë vendim miratohet propozimi i kryetarit të Komunës së Junikut për ndryshimin e planit të buxhetit për shkak të rritjes së të hyrave vetanake gjatë vitit 2022 sipas tabelës dhe sqarimit në vijim:

Tabela e planit dhe realizimit të të hyrave vetanake Janar - Gusht 2022

Nr.	Te hyrat	Planifikimi	Realizimi Janar – Gusht 2022	Diferenca (+, -)
1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	11,481.00	8,854.86	(2,626.14)
2	Te hyrat nga urbanizmi	19,100.00	12.00	(19,088.00)
3	Te hyrat nga administrata	7,100.00	4,672.50	(2,427.50)
4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	10,000.00	5,487.66	(4,512.34)
5	Te hyrat nga tatimi në pronë dhe në tokë	92,557.00	78,493.42	(14,063.58)
6	Regjistrimi i Automjeteve	6,000.00	5,538.50	(461.50)
7	Te hyrat nga shëndetësia	6,200.00	4,478.50	(1,721.50)
8	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	4,100.00	1,295.00	(2,805.00)
9	Të hyrat tjera	2,500.00	191,924.75	189,424.75
	TOTALI	159,038.00	300,757.19	141,719.19

Shuma totale e të hyrave vetanake të inkasuara në periudhën Janar – Gusht 2022 duke përfshirë të gjitha të hyrat është gjithsejtë: **300,757.19€**. Shuma e planifikuar për vitin 2022 është **159,038.00€**, ku shifet se kemi tejkalim të inkasimit të të hyrave vetanake për periudhën Janar – Gusht 2022 në vlerë prej **141,719.19€** në këtë shumë janë të përfshira edhe të hyrat nga Gjobat në trafik në shumë prej 2,622.50€.

Ne mënyrë që të mundemi ti alokojmë tejkalimin e të hyrave, kërkojmë që të rritet planifikimi i të hyrave vetanake në shumë prej **141,719.19€**, totali i të hyrave për vitin 2022 të rritet nga 159,038.00€ në 300,757.19€.

Kjo rritje në vlerë prej **141,719.19€**, të bartet si në vijim :

- Nën programi 48020 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Bashkëfinancimi i projekteve me kod të projektit 46030 – 80,000.00€.
- Nën programi 48020 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Ndërtimi i kanaleve të ujitjes me kod të projektit 47283 – 2,000.00€.
- Nën programi 66405 Planifikimi urbanizmi në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin “Asfaltimi i rrugëve lokale” me kod të projektit 45605 – 8,000.00€.
- Nën programi 93570 Arsimi fillor – Junik përkatësisht 93571 Shkolla fillore “Edmond Hoxha” Junik, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve – 10,000.00€.
- Nën programi 18020 Shërbime Publike Infrastruktura - rrugore, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve – 10,000.00€.
- Nën programi 66405 Planifikimi urbanizmi, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve – 31,719.19€.

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në realizimin e të gjitha procedurave administrative lidhur me ndryshimet e planit të buxhetit për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2022, nga pika I. e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Shpejtim Gacaferi

